

VENDIM
Nr. 2, datë 31.1.2018

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare gjyqësore Belma Lleshi, në datën 31.1.2018, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 3, akti, që i përket:

KËRKUES: Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, zoti Bashkim Dedja

OBJEKTI: Deklarimi i mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Besnik Imeraj

BAZA LIGJORE: Nenet 127/1/c dhe 127/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 9/1/c dhe 9/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatimin e bërë nga kryetari dhe administroi dokumentacionin e çështjes,

VËREN:

1. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me dekretin nr. 8066, datë 22.3.2013, ka emëruar zotin Besnik Imeraj anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 7/2013, datë 1.4.2013, ka dhënë pëlqimin për emërimin e tij si anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Më pas, zoti Imeraj ka bërë betimin para Presidentit të Republikës.

2. Në datën 31.1.2018, zoti Besnik Imeraj ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga detyra e gjyqtarit kushtetues për arsye personale e shëndetësore, sipas nenit 127/1-c të Kushtetutës dhe nenit 9/1-c të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, si dhe nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

3. Në datën 31.1.2018, Kryetari ka paraqitur para kësaj Gjykate kërkesën për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Besnik Imeraj, për shkak se ka dhënë dorëheqjen nga funksioni i anëtarit të Gjykatës Kushtetuese për arsye personale dhe shëndetësore.

4. Në nenin 127/2 të Kushtetutës, si dhe nenin 9/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet se mbarimi i mandatit të gjyqtarit deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Meqenëse dorëheqja është një akt i vullnetshëm dhe shkak kushtetues e ligjor për mbarimin e mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, atëherë kjo kërkesë për deklarimin e mbarimit të mandatit është e bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 127/1/c dhe 127/2 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9/2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Besnik Imeraj, në datën

31.1.2018, për shkak të heqjes dorë prej tij.

- Njoftimin e këtij vendimi Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha